



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr 220, date 16.03.2012

“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12 .03.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, neni 61, shkronja d datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ketu dhe me poshte Ligji.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin praparak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, Nr.35/1prot, dt.02.03.2012,

VËREN SE:

Në bazë të një ankese nga një ndërmarrje dhe pas monitormit të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 211, datë 23.12.2011 “Për hapjen e procedurës së

hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar procedurat e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Sipas evidencave të administruara gjatë inspektimeve të befasishme rezulton se në dokumentat e këtyre ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e tenderave publike ka shenja të bashkëpunimit (*gabime drejtshkimore; formularë të leshuar në të njëjten datë dhe numra serial te nje pasnjeshem nga kompani sigurimi te njëjta; të njëjtën formulim, formatim në ofertën ekonomike etj*) të cilat tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetër.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezulton se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Saimiri Al”, “NAZERI – 2000”, dhe “Dea Security” gjatë procedurave të prokurimeve publike, çka mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Pra, konkluzionet e hetimit paraprak tregojnë për një bashkëpunim të mundshëm në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Saimiri Al”, “Nazeri – 2000”, dhe “Dea Security” sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, neni 61, shkronja d datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit,

V E N D O S I:

I. Marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjet: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, që t’i japin fund bashkëpunimit mes tyre për gjatë procedurave të prokurimeve publike në tregun e shërbimeve të rojeve fizike dhe i detyron këto ndërmarrje të sillen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë procedurave të prokurimeve publike sa i përket caktimit të çmimit të ofertës dhe/ose ndarjes së tregut përkatës.

II. Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme, i cituar në pikën 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit

III. Masat e përkohshme duhet të zbatohen që nga momenti i marrjes dijeni të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R